Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 380/01
Datë 06.11.2015

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4, 7, 10, 11, 16 dhe 17, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 06.11.2015 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për riakreditimin dhe rivalidimin e Qendrës Regjonale për Aftësim Profesional, në Gjakovë për periudhën 06.11.2015 deri 06.11.2018 për të ofruar:

1.1 Asistent Administrativ, niveli III i KKK.

Riakreditimi dhe rivalidimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Të avancohet dhe të bëhet inskenimi dhe përdorimi i paisjeve teknologjike në rolin e asistentit administrativ.
- Rishikimi i kriterit hyrës për kandidatet në kualifikimin "Asistent Administrativ" për të krijuar mundësinë e kalimit në nivelin 4 të KKK-së.
- Kriteri kalueshmërisë duhet të jetë standardë në kuoten 70 % nga materja.
- Rekomandohet ngritja profesionale e stafit.
- Trajnerja të përditësojë njohuritë e saj duke ndjekur trajnime dhe seminare që lidhen me fushën e saj.

(Afati kohor i këtyre kushteve: 01.04.2016).

1.2 Saldim, niveli III i KKK.

Riakreditimi dhe rivalidimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Zgjerimi i hapësirës ekzistuese ku përfillen parametrat për zhvillimin normal të trajnimit.
- Pajisja e kabinetit me teknologji të reja e sidomos e atyre për ekzamimin e lidhjeve të salduara.
- Materiali për justifikim-dëshmitë e theksuara ne Raportin e vetëvlerësimit propozojmë të sistemohen ne përputhje me aplikacionet.

(Afati kohor i këtyre kushteve: 01.04.2016).

2. Për akreditimin dhe validimin e Qendrës Regjonale për Aftësim Profesional, në Gjakovë për periudhën 06.11.2015 deri 01.11.2018 për të ofruar:

2.1 Menaxher i ndërmarrjeve mikro dhe te vogla (Themelues i Biznesit), niveli III i KKK.

Akreditimi dhe validimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Të sigurohet materiali mësimor (paketa mësimore) për pesëmarrësit në trajnime.
- Të sigurohet bashkëpunimi me kompanitë private për pjesëmarrësit/kandidatët në këtë trajnim.
- Të sigurohen të gjitha mjetet e punës (projektori) në sallën e trajnimit.

(Afati kohor i këtyre kushteve: 01.04.2016).

1. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

- Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit;
- Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
- Raporti i Vetë-vlerësimit;
- Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1 Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi i dërgohet:

   - QRAP Gjakovë;
   - AKK.

Nën- Kryetari i KD së AKK-së
Anton Gojani